Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008), në nenin 22, paragrafi 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.8/2019) është në fuqi prej 11.09.2019, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim shqyrtoji kërkesën e parashtruar nga Ilir Ferati Nr.04-016-41292 për pezullimin e vendit të punës dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M PËR PEZULLIMIN E VENDIT TË PUNËS

1. **I PEZULLOHET** vendi i punës **Ilir Feratit**, Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Projekte në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik, i cili kandidon për deputet në zgjedhjet Parlamentare-Qendrore.
2. Kandidatit të lartëpërmendur i pezullohet vendi i punës nga data 18.09.2019 deri me 09.10.2019.
3. Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të percjellë Vendimin tek Divizioni i Pagesave në Ministrinë e Financave për Ilir Feratin të cilit i pezullohet vendi i punës sipas pikës 2 të këtij Vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Menaxheri i Personelit.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Ilir Ferati, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Menaxheri i Personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-609/019	Data: Datum: 18.09.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 22, paragrafi 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.8/2019) është në fuqi prej 11.09.2019, Drejtoria për Administratë Komunale shqyrtoji kërkesën e parashtruar nga Fazli Stollaj Nr.02-016-42709 për pezullimin e vendit të punës dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M PËR PEZULLIMIN E VENDIT TË PUNËS

- 1. I PEZULLOHET** vendi i punës **Fazli Stollaj**, Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informative në Drejtorinë për Administratë Komunale, i cili kandidon për deputet në zgjedhjet Parlamentare-Qendrore.
- Kandidatit të lartëpërmendur i pezullohet vendi i punës nga data 18.09.2019 deri me 09.10.2019.
- Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të percjellë Vendimin tek Divizioni i Pagesave në Ministrinë e Financave për Fazli Stollin të cilit i pezullohet vendi i punës sipas pikës 2 të këtij Vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Menaxheri i Personelit.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Fazli Stollaj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Menaxheri i Personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-610/019	Data: Datum: 18.09.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 56 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 dhe në nenin 22, paragrafi 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat e Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.8/2019) është në fuqi prej 11.09.2019, sipas detyrës zyrtare nxjerr:

V E N D I M PËR PEZULLIMIN E VENDIT TË PUNËS

- 1. I PEZULLOHET** vendi i punës **Emina Coković**, Zyrtare për Buxhet dhe Financa në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, e cila kandidon për deputete në zgjedhjet Parlamentare-Qendrore.
- Kandidatës së lartëpërmendur i pezullohet vendi i punës nga data 18.09.2019 deri me 09.10.2019.
- Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të percjellë Vendimin tek Divizioni i Pagesave në Ministrinë e Financave për Emina Coković të cilës i pezullohet vendi i punës sipas pikës 2 të këtij Vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Menaxheri i Personelit.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Emina Coković, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Menaxheri i Personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-611/019	Data: Datum: 18.09.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-15058 të datës 15.04.2019 e parashtruar nga z.Ramadan Quni, nga Fsh. Serbobran, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.06-553-15058 të datës 15.04.2019 e parashtruar nga z.Ramadan Quni, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim dhe me propozim të Komisionit i ndahen 150€(njëqindë e pesëdhjetë euro) nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Ramadan Quni, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Ramadan Quni, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-15058 të datës 15.04.2019, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se z.Ramadan Quni është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Ramadan Quni në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen z.Ramadan Quni, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-614/019	Data: Datum: 19.09.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.01-553-40878 të datës 06.09.2019 e parashtruar nga z.Musa Vuthaj, nga fsh.Vrellë, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.01-553-40878 të datës 06.09.2019 e parashtruar nga Musa Vuthaj për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 150€(njëqindë e pesëdhjetë euro) nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Musa Vuthaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Musa Vuthaj, ka parashtruar kërkesën Nr.01-553-40878 të datës 06.09.2019, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim.
Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se z.Musa Vuthaj është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme. I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim. Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.
Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Musa Vuthaj në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.
Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: z.Musa Vuthaj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-615/019	Data: Datum: 19.09.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.01-553-41501 të datës 10.09.2019 e parashtruar nga znj.Resmije Shatri, nga fsh.Tomoc, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e saj, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.01-553-41501 të datës 10.09.2019 e parashtruar nga znj.Resmije Shatri, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 150€(njëqindë e pesëdhjetë euro) nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e znj.Resmije Shatri,, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiave.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

znj.Resmije Shatri, ka parashtruar kërkesën Nr.01-553-41501 të datës 10.09.2019, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendures dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se znj.Resmije Shatri, është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme. E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim.

Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e znj.Resmije Shatri, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: znj.Resmije Shatri, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-616/019	Data: Datum: 19.09.2019	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), me kërkesë të Prokurimit, për formim të komisionit për pranimin e punëve për projektin: “Rregullimi i memorialit Ibrahim Rugova” vazhdim i projektit faza e IV, me numer të brendshëm prokurimi 633/018/521 dhe aneks kontrata Nr.633-018-097-522, nxjerr:

V E N D I M

1. **FORMOHET:** Komisioni për pranimin e punëve për projektin: “Rregullimi i memorialit Ibrahim Rugova” vazhdim i projektit faza e IV, me numer të brendshëm prokurimi 633/018/521 dhe aneks kontrata Nr.633-018-097-522, të cilin projekt e ka realizuar operatori “Ceta General Invest Grup” SHPK nga Istogu dhe në komision caktohen:

1. **Rexhep Blakaj**, Arkitekt-Udhëheqës i Sektorit për Urbanizëm, Kryesues i komisionit;
2. **Naser Gjocaj**, inxh i Ndertimtarisë-Udhëheqës i Sektorit për Mjedis dhe Eficiencë anëtar;
3. **Hysen Mehmetaj**, Inspektor i Tregut, anëtar;
4. **Fazli Stollaj**, Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informative, anëtar; dhe
5. **Arlinda Kurtaj**, Udhëheqëse e Sektorit Administrativ, anëtare.

2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e projektit me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së projektit; do të njoftoj mbikëqyrësin e projektit, do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartëcekur; do të hartojë procesverbalin për pranimin teknik të projektit si dhe do t'i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e komisionit të tillë.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Prokurimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, operatori “Ceta General Invest Grup” SHPK dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-620/019	Data: Datum: 23.09.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) dhe në bazë të nenit 18, paragrafi 7 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr.03/L-149 dhe nenin 7, paragrafi 1 dhe 5 i Rregullores Nr.02/2010 për Procedurën e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me qëllim të intervistimit të kandidatëve që kanë konkurruar në konkursin për kryerjen e punëve me Marrëveshje për shërbime të veçanta 02 Nr.217/019 të datës 10.09.2019, nxjerr:

V E N D I M

1. **FORMOHET:** Komisioni për intervistimin e kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin për kryerjen e punëve me Marrëveshje për shërbime të veçanta 02 Nr.217/019 të datës 10.09.2019 për pozitën: Zyrtar/e për Biblioteka në Bibliotekën e Qytetit në Istog filiala në Gjurakoc, 1 (një) ekzekutues, në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe komision caktohen:
 1. **Bedri Hajzeraj**, Udhëheqës i Sektorit për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues i Komisionit;
 2. **Qefser Ibrahimaj**, Zyrtare e Lartë për Trashëgimi Kulturore dhe Arkiv të Qytetit, anëtare;
 3. **Rasim Mahmutović**, Udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim, anëtar;
 4. **Agim Ahmetaj**, Zyrtare për Informim dhe Alarmim, anëtar;
 5. **Sahadete Aliu**, Zyrtare e Gjendjes Civile, anëtare.
2. Komisioni i cekur do të mbajë intervistimin me kandidatët të cilët kanë konkurruar për pozitën: Zyrtar/e për Biblioteka në Bibliotekën e Qytetit në Istog filiala në Gjurakoc, 1 (një) ekzekutues, në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, në pajtim me procedurat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurën e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me listën e ngushtë të kandidatëve të renditur sipas pikëve të fituara të njoftoj Menaxherin e Personelit për procedim të mëtejshëm.
3. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë, Zyra e Personelit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Komisioni.

Me nga një kopje të këtij Vendimi të njoftohet: Komisioni, Menaxheri i Personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-624/019	Data: Datum: 23.09.2019	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), me kërkesë të Prokurimit, për formim të komisionit për pranimin e dokumentacionit për projektin: "Hartimi i projektit kryesor për kanalizimin e ujërave fekale për lagjen e të kthyerëve në fsh.Serbobran, me numer të kontratës 633-019-634-2-1-1/FA/031, nxjerr:

V E N D I M

1. **FORMOHET:** Komisioni për pranimin e dokumentacionit për projektin: "Hartimi i projektit kryesor për kanalizimin e ujërave fekale për lagjen e të kthyerëve në fsh.Serbobran, me numer të kontratës 633-019-634-2-1-1/FA/031, të cilin projekt e ka realizuar operatori NTSH "Infatek" nga Prishtina dhe në komision caktohen:
 1. **Rasim Mahmutović,** Udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim, Kryesues i komisionit;
 2. **Abedin Neziraj,** Zyrtar për Kthim të Qëndrueshëm, anëtar;
 3. **Muhamet Maleshaj,** Zyrtar për Kordinimin e të Drejtave dhe Integrim të Komuniteteve, anëtar.
2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë hartuesin e projektit me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së projektit; do të njoftojë Kryetarin lidhur me hartimin e projektit të lartëcekur; do të hartojë procesverbalin për pranimin e dokumentacionit si dhe do t'i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e komisionit të tillë.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Prokurimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, operatori NTSH "Infatek" dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
 Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-626/019	Data: Datum: 24.09.2019	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit për projektin: "Ndertimi i ujësjellësit Kodra e Dynës-Lugu i Butë", me numer të brendshëm prokurimi 633-019-080-521, nxjerr:

V E N D I M

- FORMOHET:** Komisioni për vlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit për projektin: "Ndertimi i ujësjellësit Kodra e Dynës-Lugu i Butë", me numer të brendshëm prokurimi 633-019-080-521 dhe në komision caktohen:
 - Naser Gjoci**, Udhëheqës i Sektorit për Mjedis dhe Eficiencë Kryesues i Komisionit;
 - Hekuran Rugova**, Zyrtar për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve, Kapitale, anëtar;
 - Agim Ahmetaj**, Zyrtar për Emergjencë, anëtar;
- Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin: "Ndertimi i ujësjellësit Kodra e Dynës-Lugu i Butë", si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.
- Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisionit dhe Prokurimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohet: Komisioni, Prokurimi, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-628/019	Data: Datum: 25.09.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e KQZ për mbeshtetje të Komisionit Komunal për Zgjedhje për lejimin e shfrytëzimit të automjetit të komunës, dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa e KQZ për mbeshtetje të Komisionit Komunal për Zgjedhje dhe i lejohe shfrytëzimi i automjetit TOYOTA 03Z-18-06, i cili është në pronësi të komunës.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit në sasi sipas nevojës në pajtim me procedurat të cilat vlejnë për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit.
3. Komisioni Komunal për Zgjedhje mundet të shfrytëzojë automjetin e lartëpërmendur për nevojat e komisionit deri sa të kryhen zgjedhjet parlamentare.
4. Automjetin mund të ngas Bashkim Ademaj-Kryetar i KKZ-së si dhe anëtarët e komisionit.
5. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Përgjegjësi i Autoparkut.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimin të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Bashkim Ademaj-Kryetar i KKZ-së, Përgjegjësi i Autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor

Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
 Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-629/019	Data: Datum: 26.09.2019	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për caktimin e mbikqyrësit për realizimin e projekteve: "Renovimi i nyjeve sanitare në K.F. "Ardhmeria Jonë" dhe "Pëllumbat e Ardhmërisë" Lloto 2, me numër të brendshëm të prokurimit 633/019/041/521, nxjerr:

V E N D I M

1. **CAKTOHET:** mbikëqyrëse Mirjeta Beqiraj-Drejtoreshë e Qerdhës Pëllumbat e ardhmërisë, në Drejtorin për Arsim, për realizimin e projekteve: "Renovimi i nyjeve sanitare në K.F. "Ardhmeria Jonë" dhe "Pëllumbat e Ardhmërisë" Lloto 2, me numër të brendshëm të prokurimit 633/019/041/521, të cilin është duke e realizuar operatori "Natoni" SHPK nga Komuna e Istogut.
2. E lartpërmendura do të bëjë mbikëqyrjen e realizimit të projektit të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi sipas projekti detal ekzekutive; do të njoftoj kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punëve; do të njoftoj Kryetarin rregullisht lidhur me realizimin e punimeve sipas projektit të cekur dhe me vështirësitë eventuale që paraqiten gjatë mbikëqyrjes së punëve, si dhe do t'i kryejë edhe punë dhe detyra të tjera që janë të natyrës së tillë.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij kujdeset: Mbikëqyrësi i projektit, Prokurimi dhe Drejtoria për Arsim.
4. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Mirjeta Beqiraj, operatori "Natoni" SHPK, Prokurimi, Drejtoria për Arsim dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-631/019	Data: Datum: 26.09.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-11030 të datës 19.03.2019 e parashtruar nga z.Haki Murataj, nga Fsh.Suhogerllë, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e nënës së tij, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.06-553-11030 të datës 19.03.2019 e parashtruar nga z.Haki Murataj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim të Nënës, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 150€(njëqindë e pesëdhjetë euro) nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Haki Murataj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Haki Murataj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-1683 të datës 14.01.2019, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërimin e nënës Sofije Murataj.
 Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Sofija është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme.
 I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim.
 Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.
 Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Haki Murataj në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.
 Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.
 Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: z.Haki Murataj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-632/019	Data: Datum: 26.09.2019	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për caktimin e mbikëqyrësit për realizimin e projektit: "Renovimi i nyjeve sanitare në shkollën fillore të lartë "Trepça" në Banjë" Loto 5, me numër të brendshëm të prokurimit 633/019/041/521, nxjerr:

V E N D I M

1. **CAKTOHET:** mbikëqyrës **Nexhmedin Beqiraj**-Drejtor në SHFMU "Trepça" në Banjë, në Drejtorin për Arsim, për realizimin e projektit: "Renovimi i nyjeve sanitare në shkollën fillore të lartë "Trepça" në Banjë" Loto 5, me numër të brendshëm të prokurimit 633/019/041/521, të cilin është duke e realizuar operatori "Natoni" SHPK nga Komuna e Istogut.
2. I lartpërmenduri do të bëjë mbikëqyrjen e realizimit të projektit të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi sipas projekti detal ekzekutive; do të njoftoj kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punëve; do të njoftoj Kryetarin rregullisht lidhur me realizimin e punimeve sipas projektit të cekur dhe me vështirësitë eventuale që paraqiten gjatë mbikëqyrjes së punëve, si dhe do t'i kryejë edhe punë dhe detyra të tjera që janë të natyrës së tillë.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij kujdeset: Mbikëqyrësi i projektit, Prokurimi dhe Drejtoria për Arsim.
4. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimit të njoftohen: **Nexhmedin Beqiraj**, operatori "Natoni" SHPK, Prokurimi, Drejtoria për Arsim dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-633/019	Data: Datum: 26.09.2019	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për caktimin e mbikqyrësit për realizimin e projektit: "Renovimi i kulmit në SHFMU "Hysni Zajmi" në Vrellë" Loto 4, me numër të brendshëm të prokurimit 633/019/041/521, nxjerr:

V E N D I M

1. **CAKTOHET:** mbikëqyrës **Sadik Bicaj**-Drejtore në SHFMU "Hysni Zajmi" në Vrellë, në Drejtorin për Arsim, për realizimin e projektit: "Renovimi i kulmit në SHFMU "Hysni Zajmi" në Vrellë" Loto 4, me numër të brendshëm të prokurimit 633/019/041/521, të cilin është duke e realizuar operatori "Kabashi" SHPK nga Komuna e Istogut.
2. I lartpërmenduri do të bëjë mbikëqyrjen e realizimit të projektit të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi sipas projekti detal ekzekutive; do të njoftoj kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punëve; do të njoftoj Kryetarin rregullisht lidhur me realizimin e punimeve sipas projektit të cekur dhe me vështirësitë eventuale që paraqiten gjatë mbikëqyrjes së punëve, si dhe do t'i kryejë edhe punë dhe detyra të tjera që janë të natyrës së tillë.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij kujdeset: Mbikëqyrësi i projektit, Prokurimi dhe Drejtoria për Arsim.
4. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Sadik Bicaj, operatori "Kabashi" SHPK, Prokurimi, Drejtoria për Arsim dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-634/019	Data: Datum: 26.09.2019	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për caktimin e mbikëqyrësit për realizimin e projektit: "Renovimi i kulmit në SHFMU "Martin Camaj" Loto 3 në Gurakoc, me numër të brendshëm të prokurimit 633/019/041/521, nxjerr:

V E N D I M

1. **CAKTOHET:** mbikëqyrës **Niman Curraj**-Drejtor në SHFMU "Martin Camaj" në Gurakoc, në Drejtorin për Arsim, për realizimin e projektit: "Renovimi i kulmit në SHFMU "Martin Camaj" Loto 3 në Gurakoc, me numër të brendshëm të prokurimit 633/019/041/521, të cilin është duke e realizuar operatori "Kabashi" NN nga Komuna e Istogut.
2. I lartpërmenduri do të bëjë mbikëqyrjen e realizimit të projektit të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi sipas projekti detal ekzekutive; do të njoftoj kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punëve; do të njoftoj Kryetarin rregullisht lidhur me realizimin e punimeve sipas projektit të cekur dhe me vështirësitë eventuale që paraqiten gjatë mbikëqyrjes së punëve, si dhe do t'i kryejë edhe punë dhe detyra të tjera që janë të natyrës së tillë.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij kujdeset: Mbikëqyrësi i projektit, Prokurimi dhe Drejtoria për Arsim.
4. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Niman Curraj, operatori "Kabashi" NN, Prokurimi, Drejtoria për Arsim dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-635/019	Data: Datum: 26.09.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), shqyrtoi kërkesën Nr.01-553-44020, të datës 25.09.2019 të parashtruar nga Blearta Balaj, nga Lluga, për përkrahje furnizim të automjetit me karburant dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MITATOHET:** kërkesa Nr.01-553-44020, të datës 25.09.2019, e parashtruar nga Blearta Balaj, për përkrahje me karburant për realizimin e vizitave mjekësore dhe i lejohet furnizimi i automjetit me 80 litra karburant për një muaj.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë të lartpërmendurën me Vërtetim për furnizim të automjetit me karburant në sasinë e cekur në pikën 1 të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburante të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Zyrës Kryetarit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Blearta Balaj, ka parashtruar kërkesën Nr.01-553-44020, të datës 25.09.2019, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i saj për realizimin e vizitave mjekësore jashtë shteti.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Blearta është e sëmurë.

E lartpërmendura është e sëmurë rënd dhe nuk ka mjete financiare të mjaftueshme që të sigurojë transportin e saj. Duke pasur parasysh gjendjen ekonomiko-sociale, nuk ka mundësi që t'i bartë të gjitha shpenzimet e transportit dhe është e arsyeshme që t'i ndihmohet përmes furnizimit me karburant të automjetit.

Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurën më Vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Zyrës Kryetarit, në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Administratë do të kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u theksua u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Blearta Balaj, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-636/019	Data: Datum: 27.09.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) dhe në bazë të nenit 18, paragrafi 7 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr.03/L-149 dhe nenin 7, paragrafi 1 dhe 5 i Rregullores Nr.02/2010 për Procedurën e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me qëllim të intervistimit të kandidatëve që kanë konkurruar në konkursin 02 Nr.218 /019 të datës 10.09.2019, nxjerr:

V E N D I M

- FORMOHET:** Komisioni për intervistimin e kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin 02 Nr.218/019 të datës 10.09.2019 për pozitën: Zyrtar i Lartë për punë profesionale për Kuvendin Komunal, me numër të referencës RN00005604, 1 (një) ekzekutues, në kuadër të Zyrës së Kuvendit dhe komision caktohen:
 - Zekije Sutaj**, Udhëheqëse e Sektorit Ligjor, Kryesuese e Komisionit;
 - Floriye Bytyçi**, Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Ulët, anëtare;
 - Faton Bujupi**, Zyrtar Ligjor 1, anëtar;
 - Abedin Neziraj**, Zyrtar për Kthim të Qëndrueshëm, anëtar.
 - Shahe Mulaj**, Zyrtare e të Hyra Financiare, anëtare;]
- Komisioni i cekur do të mbajë intervistimin me kandidatët të cilët kanë konkurruar për pozitën: Zyrtar i Lartë për punë profesionale për Kuvendin Komunal, me numër të referencës RN00005604, 1 (një) ekzekutues, në kuadër të Zyrës së Kuvendit, në pajtim me procedurat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurën e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me listën e ngushtë të kandidatëve të renditur sipas pikëve të fituara të njoftoj Menaxherin e Personelit për procedim të mëtejshëm.
- Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë, Zyra e Personelit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni.

Me nga një kopje të këtij Vendimi të njoftohet: Komisioni Menaxheri i Personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



**Kryetari i Komunës
 Haki RUGOVA**

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-638/019	Data: Datum: 27.09.2019	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) dhe në bazë të nenit 18, paragrafi 7 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr.03/L-149 dhe nenin 7, paragrafi 1 dhe 5 i Rregullores Nr.02/2010 për Procedurën e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me qëllim të intervistimit të kandidatëve që kanë konkurruar në konkursin 02 Nr.221/019 të datës 02.09.2019, nxjerr:

V E N D I M

1. **FORMOHET:** Komisioni për intervistimin e kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin 02 Nr.221/019 të datës 02.09.2019 për pozitën: Sekretar Shkolle në SHFMU "Trepça" në Banjë, me numër të referencës RN00005501, 1 (një) ekzekutues dhe komision caktohen:
 1. Nexhmedin Beqiraj, Drejtor i SHMU "Trepça" në Banjë, Kryesues i Komisionit;
 2. Arlinda Kurtaj, Udhëheqëse e Sektorit për Punë Administrative të Kuvendit Komunal, anëtare;
 3. Sami Metaj, Zyrtar i Lartë Ligjor, anëtar;
 4. Faton Bujupi, Zyrtare e Ligjor, anëtar; dhe
 5. Abedin Neziraj, Zyrtar për Kthim të Qëndrueshëm, anëtar.
2. Komisioni i cekur do të mbajë intervistimin me kandidatët të cilët kanë konkurruar për pozitën: Sekretar Shkolle në SHFMU "Trepça" në Banjë, me numër të referencës RN00005501, 1 (një) ekzekutues, në pajtim me procedurat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurën e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me listën e ngushtë të kandidatëve të renditur sipas pikëve të fituara të njoftoj Menaxherin e Personelit për procedim të mëtejshëm.
3. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë, Zyra e Personelit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Komisioni.

Me nga një kopje të këtij Vendimi të njoftohet: Komisioni, Menaxheri i Personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-639/019	Data: Datum: 27.09.2019	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit për projektin: Loto 1 "Ndërtimi i rrugës në Kërrninë dhe Loto 2 "Asfaltimi i rrugës Podguri-Lagjan Metaj-Shushicë e Ulët", me numer të brendshëm prokurimi 633-019-077-521, nxjerr:

V E N D I M

- FORMOHET:** Komisioni për vlersimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit për projektin: Loto 1 "Ndërtimi i rrugës në Kërrninë dhe Loto 2 "Asfaltimi i rrugës Podguri-Lagjan Metaj-Shushicë e Ulët", dhe në komision caktohen:
 - Naser Gjoci**, Udhëheqës i Sektorit për Mjedis dhe Eficiencë Kryesues i Komisionit;
 - Arta Fetahu**, Zyrtare për Planifikim dhe Zhvillim, anëtare;
 - Naser Nimanaj**, Zyrtar i lartë për Infrastrukturë Rrugore, anëtar;
- Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin: Loto 1 "Ndërtimi i rrugës në Kërrninë dhe Loto 2 "Asfaltimi i rrugës Podguri-Lagjan Metaj-Shushicë e Ulët", si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.
- Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisionit dhe Prokurimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohet: Komisioni, Prokurimi, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




**Kryetari i Komunës
 Haki RUGOVA**


 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-639/019	Data: Datum: 27.09.2019	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit për projektin: Loto 1 "Ndërtimi i rrugës në Kërrninë dhe Loto 2 "Asfaltimi i rrugës Podguri-Lagjan Metaj-Shushicë e Ulët", me numer të brendshëm prokurimi 633-019-077-521, nxjerr:

V E N D I M

- FORMOHET:** Komisioni për vlersimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit për projektin: Loto 1 "Ndërtimi i rrugës në Kërrninë dhe Loto 2 "Asfaltimi i rrugës Podguri-Lagjan Metaj-Shushicë e Ulët", dhe në komision caktohen:
 - Naser Gjoci**, Udhëheqës i Sektorit për Mjedis dhe Eficiencë Kryesues i Komisionit;
 - Arta Fetahu**, Zyrtare për Planifikim dhe Zhvillim, anëtare;
 - Naser Nimanaj**, Zyrtar i lartë për Infrastrukturë Rrugore, anëtar;
- Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin: Loto 1 "Ndërtimi i rrugës në Kërrninë dhe Loto 2 "Asfaltimi i rrugës Podguri-Lagjan Metaj-Shushicë e Ulët", si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.
- Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisionit dhe Prokurimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohet: Komisioni, Prokurimi, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-641/019	Data: Datum: 30.09.2019	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 19 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.72/2010) Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurën e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe në bazë të rekomandimeve të Komisionit përzgjedhës, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** propozimi i Komisionit përzgjedhës për vendin e punës: Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike në Drejtorinë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
2. Për Vendin e punës: Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, pranohet **Naser Gjocaj**.
3. I lartëpërmenduri punës ja fillon nga data 01.10.2019.
4. Obligohet Personeli që të zbatoj këtë vendim.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Naser Gjocaj, Personeli, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ


